

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

MENAXHIMI STRATEGJIK I MJEDISIT JETËSOR NË NIVEL LOKAL



ЗАЕДНО ЗА
КЛИМАТСКА
АКЦИЈА

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

MENAXHIMI STRATEGJIK I MJEDISIT JETËSOR NË NIVEL LOKAL

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Autor

Bojan Trpevski

Projekti

Organizatata civile në veprim për ndryshimet klimatike

Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

Redaktimi gjuhësor

Eleonora Stojkoska –Popetrevska

Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi

Rexhep Xheladini

Dizajn grafik

Haris Muriq

Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Organizatata civile në veprim për klimën", mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

| | |
|--|----|
| SHKURTESAT | 1 |
| HYRJE | 2 |
| METODOLOGJIA | 2 |
| PLAN VEPRIMI LOKAL EKOLOGJIK PËR MJEDISIN JETËSOR | 3 |
| ZBATIMI I MIRATIMIT TË PVL MJ-SË | 4 |
| KONKLUZIONE | 10 |
| REKOMANDIME | 11 |

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT

| | | |
|--------------|-------|---|
| LMJ | _____ | Ligji i Mjedisit Jetësor |
| PVLMJ | _____ | Plan Veprimi Lokal për Mjedisin Jetësor |
| MMJPH | _____ | Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor |
| PVN | _____ | Plan Veprimi Nacional për Mjedisin Jetësor |
| RM | _____ | Republika e Maqedonisë |
| RMV | _____ | Republika e Maqedonisë së Veriut |

HYRJE

Mjedisi jetësor përfshinë hapësirën në të cilën jetojnë dhe ekzistojnë të gjithë organizmat e gjalla, përfshirë njerëzit. Çdo aktivitet i njeriut ndikon në gjendjen e mjedisit dhe të ekosistemeve dhe organizmave të tjerë (bimë, kafshë, insekte, etj.). Prandaj, detyra jonë është të minimizojmë ndikimin negativ në mjedisin jetësor si rezultat i aktiviteteve tona.

Organizimi i njerëzve në shoqëri nënkupton edhe dorëzimin e sovranitetit të shtetit, i cili si konstrukt shoqëror ka detyrimin të kujdeset për përdorimin dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore dhe vendos rregulla dhe standarde për të minimizuar ndotjen e mjedisit jetësor.

Ligji për Mjedisin Jetësor përcakton planet lokale të veprimit ekologjik për mjedisin jetësor si mekanizëm për planifikimin dhe menaxhimin strategjik dhe të gjerë të mjedisit jetësor në nivel lokal.

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë ka analizuar më parë menaxhimin e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike në nivel qendror, kështu që ky dokument bazohet në gjetjet e të njëjtit,¹ por edhe në dokumente të tjera të përgatitura më herët në këtë fushë.²

METODOLOGJIA

Punimi synon të arrijë objektivat e mëposhtme kërkimore:

- **Të identifikojë shkallën e zbatimit të legjislacionit për menaxhimin afatgjatë të mjedisit jetësor në nivel lokal nga një aspekt formal dhe përmbajtjesorë;**
- **Të identifikojë mangësitë në zbatimin e legjislacionit.**

Qasja metodologjike në përgatitjen e dokumentit përfshin zbatimin e metodave të mëposhtme të kërkimit:

- **Hulumtim nga zyra** – konsultim të legjislacionit përkatës nacional në lidhje me vendosjen e menaxhimit afatgjatë të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike;

Kërkesat për qasje të lirë në informacionin me karakter publik – duke përdorur instrumentin për qasje të lirë në informacionin me karakter publik për të mbledhur informacionin përkatës.

Dokumenti mbulon periudhën nga viti 2016 deri në mars 2023.

¹ Menaxhimi strategjik i mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike në nivel qendror, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2023

² Raporti teknik nr. 5 – Auditimi i PVL MJ-së, në dispozicion në:

https://www.moepp.gov.mk/wp-content/uploads/2018/03/ENV_Technical_Report_No5_ReviewofLEAPs_30.06.16.pdf

PLAN VEPRIMI LOKAL EKOLOGJIK PËR MJEDISIN JETËSOR

Plan veprimet lokale për mjedisin jetësor rregullohen me nenet 60-62 dhe nenin 64 të Ligjit për Mjedisin Jetësor.³

Këshillat e komunave, këshilli i Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit miratojnë PVLMJ-të me afat kohor prej 6 vitesh, i cili ripërtërihet në rast të ndryshimit të rrethanave. Baza për PVLMJ-në është Plan Veprimi Nacional për Mjedisin Jetësor dhe është përgatitur sipas metodologjisë së miratuar nga MMJPH-ja. Këshillat formojnë organe të menaxhuara nga kryetarët e komunave për: 1) monitorimin e zbatimit të PVLMJ-së, 2) propozimin e ndryshimeve në PVLMJ-në dhe 3) raportimin në MMJPH-jë në nivel vjetor për monitorimin e zbatimit të PVLM-së dhe ndryshimet e propozuara.

Çdo PVLMJ-në duhet të përmbajë masa dhe aktivitete afatmesme dhe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetit të njerëzve, në interes dhe kompetencë të komunës, qytetit të Shkupit dhe komunave në qytetin e Shkupit, e veçanërisht për:

1. Mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;
2. furnizimin me ujë të pijshëm cilësor në sasi të mjaftueshme;
3. mbrojtjen e ujërave nga ndotja, pastrimi i ujërave të zeza, zvogëlimi progresiv i shkarkimeve të dëmshme dhe eliminimi gradual i shkarkimeve të substancave të rrezikshme në ujëra dhe për të zbutur pasojat e efekteve të dëmshme të ujërave dhe mungesës së ujit;
4. menaxhimin e mbetjeve;
5. mbrojtjen nga zhurma dhe dridhjet që lindin si rezultat i aktiviteteve ekonomike dhe të aktiviteteve tjera;
6. zhvillimin urban dhe planifikimi hapësinor;
7. zhvillimin e transportit publik lokal dhe trafikut në zonë;
8. rritjen e efikasitetit të energjisë;
9. zhvillimin e turizmit ekologjiko-kulturor dhe ndikimi i tij në mjedis jetësor;
10. mbrojtjen e biodiversitetit;
11. menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore;
12. ngritjen e vetëdijes publike dhe zhvillimi i edukimit për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit;
13. pasojat e zhvillimit ekonomik në mjedis jetësor;
14. organet kompetente për zbatimin e elementeve të veçanta të planit.

³ Ligji i Mjedisit Jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 53/2005; 81/2005; 24/2007; 159/2008; 83/2009; 48/2010; 124/2010; 51/2011; 123/2012; 93/2013; 187/2013; 42/2014; 44/2015; 129/2015; 192/2015; 39/2016 dhe 99/2018 dhe ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 89/2022 dhe 171/2022)

ZBATIMI I MIRATIMIT TË PVLMJ-SË

Përmes semaforit të përputhshmërisë, ky kapitull do të ofrojë të dhëna për shkallën e zbatimit të legjislacionit të Maqedonisë në lidhje me miratimin e PVLMJ-së dhe monitorimin e zbatimit të tij. Vlerësimi i dokumenteve bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

1. PVLMJ-ja ka vlefshmërinë e duhur kohore:
 - a. Kohëzgjatja e PVLM-së korrespondon me kohëzgjatjen ligjore;
 - b. Komuna ka miratuar PVLMJ-në për të gjithë periudhën e hulumtimit.
2. Përmbajtja e PVLMJ-së korrespondon me rregullimin ligjor:
 - a. PVLMJ-ja mbulon plotësisht temat e përcaktuara në ligj;
 - b. PVLMJ-ja përmban masa afatmesme dhe afatgjata.

Të njëjtat kriterë vlejné edhe për aspekte të tjera.

PLAN VEPRIME LOKAL PËR MJEDISIN JETËSOR

| Komuna ⁴ | I miratuar | I ndryshuar | Organi i formuar | Raportet | Shënim |
|----------------------|------------|-------------|------------------|----------|--|
| Krivogashtani | | | | | |
| Zelenikovë | | | | | |
| Zërnovcë | | | | | |
| Konçe | | | | | |
| Butell | | | | | |
| Demir Hisar | | | | | |
| Mavrovë dhe Rostushë | | | | | Komuna ka Strategji për Ndryshimet Klimatike 2015-2025. |
| Bogovinjë | | | | | |
| Gradkso | | | | | |
| Sveti Nikollë | | | | | |
| Manastir | | | | | PVLMJ-ja i referohet periudhës 2016-2021. Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar; Në PVLMJ-në 2016-2021, në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit jetësor" nuk janë analizuar të gjithë sektorët nga neni 64 i LMJ-së, dhe në rubrikën "Plani dhe plani i zbatimit për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PVLMJ-së" masat afatmesme dhe afatgjata janë të përfshira, por nuk ka masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së. |
| Staro Nagoriçane | | | | | |

⁴ Komunat: Dibër, Demir Kapi, Kratovë, Krushevë, Negotinë, Strumicë, Shtip, Haraçinë, Vasilevë, Dollneni, Likovë, Lozovë, Rosoman, Studeniçan, Gazi Babë, Gjorçe Petrov dhe Saraj nuk iu përgjigjën parashtrësës për qasje të lirë në informacion me karakter publik

| Komuna ⁴ | I miratuar | Indryshuar | Organi i formuar | Raportet | Shënim |
|---------------------|------------|------------|------------------|----------|---|
| Bogdanci | | | | | <p>Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVLMJ-në vetëm për periudhën 2019-2025); PVLMJ-ja 2019-2025 i referohet një periudhe 7-vjeçare dhe nuk është në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së, në rubrikën "Raporti për vlerësimin e gjendjes mjedisit jetësor në Komunën e Bogdancit" jo të gjithë sektorët nga neni 64 i LMJ-së janë analizuar, në rubrikën "Plani i zbatimit dhe plani për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të LMJ-së" masat nuk janë të përfaqësuara për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së, si dhe masat e parashikuara nuk kanë vlefshmërinë e kohëzgjatjen ligjore.</p> <p>Megjithëse PVLMJ-ja mbulon periudhën 2019-2025, raporti i parë i zbatimit është për vitin 2021. Raporti më së shumti përmban informacione për rrugët e rikonstruara/ndërtuara, megjithëse nuk parashikohet asnjë masë në Planin e zbatimit të PVLMJ-së.</p> |
| Gostivar | | | | | |
| Debrca | | | | | <p>Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVLMJ-në vetëm për periudhën 2019-2025); PVLMJ-ja 2019-2025 zbatohet për një periudhë 7-vjeçare dhe nuk është në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së, në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit jetësor" nuk janë analizuar të gjithë sektorët e nenit 64 të LMJ-së, dhe në rubrikën "Plani për zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të LMJ-së" nuk përmban masa afatmesme të referuara në nenin 64 të LMJ-së dhe nuk përfaqëson masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së.</p> |
| Jegunovcë | | | | | |
| Ilinden | | | | | |
| Sopishtë | | | | | |
| Pllasnicë | | | | | |
| Kërçovë | | | | | |
| Veles | | | | | |
| Aerodrom | | | | | <p>Nga aspekti formal, komuna ka PVLMJ-në të vlefshme në periudhën e hulumtuar. PVLMJ-ja 2009-2016 zbatohet për një periudhë 8-vjeçare dhe PVLMJ-ja 2017-2023 zbatohet për një periudhë 7-vjeçare, kështu që të dy PVLMJ-të nuk përputhen me vlefshmërinë e përkohshme të nenit 60 të LMJ-së; Në PVLMJ-në 2009-2016, në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit", janë analizuar pothuajse të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së, por në PVLMJ-në 2017-2023 janë analizuar më pak fusha në krahasim me PVLMJ-në e mëparshme; Në PVLMJ 2009-2016 në rubrikën "Plani për zbatimin e PVLMJ" që përmban masa afatmesme dhe afatgjata për pothuajse të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së, por në pjesën përkatëse të PVLMJ-së 2017-2023 masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-në dhe vetëm masat afatgjata janë të përfshira. Konkluzioni i përgjithshëm është se PVLMJ-ja 2017-2023 ka një cilësi më të ulët në krahasim me PVLMJ-në 2009-2016.</p> <p>Komuna ndryshoi PVLMJ-në 2017-2023 në vitin 2022.</p> <p>Komuna do të nisë hartimin e një PVLMJ-je të re dhe do të përgatisë një raport përmbledhës për zbatimin e këtij aktual, por për faktin se nuk është krijuar asnjë organ për monitorimin e zbatimit, çështja e cilësisë dhe saktësisë së raportit përmbledhës mund të ngrihet.</p> |

| Komuna ⁴ | I miratuar | I ndryshuar | Organi i formuar | Raportet | Shënim |
|---------------------|------------|-------------|------------------|----------|---|
| Vinicë | | | | | |
| Çeshinovë-Oblesheve | | | | | Komuna nuk ka miratuar PVL MJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVL MJ-në vetëm për periudhën 2010-2016); PVL MJ-ja 2010-2016 zbatohet për një periudhë 7-vjeçare dhe nuk është në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së, në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit" jo të gjithë sektorët janë analizuar nga neni 64 i LMJ-së, në rubrikën "Plani për zbatimin e PVL MJ-së" përmban masa afatmesme dhe afatgjata, por jo për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së. Është karakteristikë se në rubrikën "Plani për zbatimin e PVL MJ-së" afati kohor për zbatimin e disa masave fillon përpara periudhës kohore për të cilën PVL MJ-ja është në fuqi. |
| Mogillë | | | | | |
| Makedonski Brod | | | | | |
| Kavadar | | | | | Komuna nuk ka miratuar PVL MJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVL MJ-në vetëm për periudhën 2022-2028); PVL MJ-ja 2022-2028 zbatohet për një periudhë 7-vjeçare dhe nuk është në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së, nuk analizon të gjithë sektorët nga neni 64 i LMJ-së, dhe në rubrikën "Plani për zbatimin e PVL MJ për komunën e Kavadarit dhe një plan për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit" përmban masa pothuajse për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ, por janë të përfaqësuara vetëm masa afatgjata, jo masa afatmesme. |
| Dellçevë | | | | | |
| Koçani | | | | | |
| Qendër | | | | | <p>Komuna ka PVL MJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (PVL MJ-ja 2013-2018 dhe PVL MJ 2019-2025); PVL MJ-ja 2019-2025 zbatohet për një periudhë 7-vjeçare dhe nuk përputhet me vlefshmërinë e përkohshme të nenit 60 të LMJ-së; Në PVL MJ-në 2013-2018 nuk janë analizuar të gjithë sektorët nga neni 64 i LMJ-së, ndërsa në PVL MJ-në 2019-2025 në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit jetësor dhe evidentimi i problemeve" pothuajse të gjitha fushat nga neni 64 i LMJ-së janë analizuar; Në PVL MJ 2013-2018 në "Planin e zbatimit të PVL MJ" ka masa afatmesme dhe afatgjata, por jo për të gjitha fushat nga neni 64 i LMJ-së dhe afati kohor për zbatimin e masave caktohet 1 vit para datës periudhës për të cilën është miratuar PVL MJ-ja, ndërsa në PVL MJ-në 2019-2025 në rubrikën "Plani i zbatimit të PVL MJ dhe plani i monitorimit" ka masa afatmesme dhe afatgjata, por jo për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-në.</p> <p>Komuna kishte shpallur thirrje për formimin e një organi për monitorimin e zbatimit të PVL MJ-së 2019-2025, por për shkak të COVID-19 nuk u formua. Për momentin, komuna ka sërish një thirrje aktive për ngritjen e një organi për monitorimin e zbatimit të PVL MJ-së.</p> |
| Bosilovë | | | | | "PVL MJ-ja i referohet periudhës 2016-2020 dhe nuk është përgatitur në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së; Komuna nuk ka miratuar PVL MJ-një me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar; Në PVL MJ 2016-2020, në rubrikën "Raporti për vlerësimin e gjendjes mjedisit jetësor në komunën e Bosilovës", nuk janë analizuar të gjithë sektorët nga neni 64 i LMJ-së dhe në rubrikën "Plani për zbatimin e PVL MJ-së" janë përfshirë masa afatmesme dhe afatgjata, por nuk ka masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së" |

| Komuna ⁴ | I miratuar | Indryshuar | Organi i formuar | Raportet | Shënim |
|---------------------|------------|------------|------------------|----------|--|
| Pehçevë | | | | | |
| Karbinci | | | | | |
| Vrapçishtë | | | | | |
| Zhelinë | | | | | |
| Qendra Zhupë | | | | | |
| Tearcë | | | | | |
| Prilep | | | | | |
| Gjevgjeli | | | | | |
| Karposh | | | | | <p>Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVLMJ vetëm për periudhën 2019-2026); Në rubrikën "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit" jo të gjithë sektorët janë analizuar nga neni 64 i LMJ-së , në rubrikën "Plani për zbatimin dhe plani për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PVLMJ-së" nuk përmban masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së (mund të veçohet si pozitive që plani përmban masa të tituluara "ndryshimet klimatike"). Mund të thuhet se përmbahen vetëm masa afatmesme, por karakteristike është se afati i zbatimit të të gjitha masave është 2016-2021, pra 3 vjet para fillimit efektiv të PVLMJ-së specifike.</p> <p>Komuna ka krijuar organ monitorues në vitin 2019 dhe për shkak të masave për të kufizuar praninë fizike të zyrtarëve në vendet e tyre të punës, nuk janë përgatitur dhe dorëzuar raportet vjetore, por është planifikuar një raport përmbledhës për të gjithë PVLMJ-në.</p> |
| Qyteti i Shkupit | | | | | <p>Komuna nuk ka një PVLMJ për periudhën 2017-2019 (PVLMJ 2 për periudhën 2010-2016 dhe PVLMJ 3 për periudhën 2020-2026); Dy PVLMJ-të hyjnë në fuqi për një periudhë 7-vjeçare dhe nuk përputhen me vlefshmërinë e përkohshme të përcaktuar nga neni 60 i LMJ-së; Në PVLMJ 2 dhe PVLMJ 3 janë analizuar pothuajse të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-në (mund të vihet re pozitivisht se PVLMJ 3 përmban një fushë tematike të veçantë "ndryshimi klimatik"); PVLMJ 2 përmban masa afatmesme dhe afatgjata, por jo për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ, ndërsa PVLMJ 3 përmban masa afatmesme dhe afatgjata për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-në (shtresëzimi i disa zonave në theksohen pozitivisht disa nënzona, si p.sh., rrezatimi jonizues dhe të ngjashme, si dhe theksohet edhe kapitulli për masat e ndryshimit të klimës). Përfundimi i përgjithshëm është se PVLMJ 3 është me cilësi më të lartë se PVLMJ 2.</p> <p>Komuna ka një sistem të organizuar monitorimi (ekip i drejtorive të qytetit me kompetenca nga fusha e PVLMJ-së, të cilat i dorëzojnë të dhënat Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor), por rezultoni se nuk është krijuar asnjë organ në përputhje me nenin 60 të LMJ-së. Nga përgjigja e komunës mund të konstatohet se punonjësit nuk janë në dijeni se dorëzimi i raporteve vjetore në MMJPH është obligim ligjor, i cili nuk varet nëse Ministria e kërkon atë nga komuna apo jo.</p> |
| Kriva Pallanka | | | | | |

| Општина | Донесен | Изменет | Формирано тело | Извештаи | Забелешка |
|-----------------------|---------|---------|----------------|----------|---|
| Resen | | | | | <p>Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVLMJ për periudhën 2017-2022): Në PVLMJ 2017-2022 nuk janë analizuar të gjithë sektorët e nenit 64 të LMJ-në, rubrika "Plani i zbatimit të PVLMJ" përmban masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, por jo për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së.</p> <p>Departamenti i Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e masave nga PVLMJ-ja, por komuna nuk e ka themeluar organin nga neni 60 i LMJ-së.</p> |
| Rankovcë | | | | | |
| Kisella Vodë | | | | | <p>Komuna ka PVLMJ-në për të gjithë periudhën e hulumtuar (PVLMJ 2016-2021 dhe PVLMJ 2022-2028), por PVLMJ e dytë nuk përputhet me kohëzgjatjen e atribuar në nenin 60 të LMJ-së; Në PVLMJ-në 2016-2021 nuk janë analizuar të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së, por në PVLMJ-në 2022-2028 janë analizuar të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së; PVLMJ 2016-2021 nuk përmban masa për të gjitha fushat nga neni 64 i LMJ-së dhe nuk është caktuar afat kohor për zbatimin e tyre, kështu që nuk mund të përcaktohet me saktësi nëse këto janë masa afatmesme apo afatgjata, ndërsa në masat PVLMJ 2022-2028 përmbahen për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ, por plani ka vetëm masa afatgjata.</p> <p>Komuna është në proces të themelimit të organit monitorues nga neni 60 i LMJ-së.</p> |
| Dojran | | | | | |
| Çair | | | | | |
| Shuto Orizari | | | | | |
| Petrovec | | | | | |
| Vallandovë | | | | | |
| Probishtip | | | | | |
| Novo Sellë | | | | | |
| Kumanovë | | | | | <p>Komuna nuk ka miratuar PVLMJ-në me vlefshmëri kohore për të gjithë periudhën e hulumtuar (komuna ka PVLMJ-në vetëm për periudhën 2022-2028); PVLMJ-ja 2022-2028 zbatohet për një periudhë 7 vjeçare dhe nuk është në përputhje me vlefshmërinë kohore të nenit 60 të LMJ-së, janë analizuar pothuajse të gjithë sektorët e nenit 64 të LMJ (si shembull pozitiv kapitulli për "ndryshimet klimatike dhe barazia gjinore" veçohet), në rubrikën "Plani për zbatimin e PVLMJ-së për komunën Kumanovës dhe plani për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit" masat për të gjitha fushat nga neni 64 i LMJ-së nuk janë të përmbajtura dhe përfaqësohen vetëm masa afatgjata, jo masa afatmesme.</p> <p>Komuna planifikon të krijojë një organ monitorues nga neni 60 i LMJ-së gjatë periudhës prill-maj 2023.</p> |
| Çashkë | | | | | |
| Kamenicë e Maqedonisë | | | | | |

| Општина | Донесен | Изменет | Формирано тело | Извештаи | Забелешка |
|---------------|---------|---------|----------------|----------|--|
| Radovishë | | | | | <p>Në përgjigjen e komunës, bëhet me dije se është miratuar Agjenda e Gjelbër 2019-2029, e cila përmban të gjitha analizat, parametrat, aktivitetet, qëllimet dhe detyrat e mbuluara nga PVLMJ-ja. Agjenda e Gjelbër si dokument strategjik nuk është e rregulluar me legjislacionin e Maqedonisë, kështu që konsiderohet se PVLMJ-ja nuk është miratuar fare në përputhje me LMJ-në.</p> <p>Dokumenti i analizuar i referohet 11 viteve dhe nuk është në përputhje me kohëzgjatjen e nenit 60 të LMJ-së; Dokumenti nuk analizon të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së; Dokumenti përmban masa të caktuara, por nuk përmban masa për të gjitha fushat e nenit 64 të LMJ-së dhe as nuk kanë kohëzgjatjen ligjore, kështu që nuk mund të vlerësohet nëse këto janë masa afatmesme apo afatgjata.</p> |
| Strugë | | | | | |
| Bërvenicë | | | | | |
| Berovë | | | | | |
| Novaci | | | | | |
| Vevçani | | | | | |
| Tetovë | | | | | |
| Çuçer Sandevë | | | | | |
| Ohër | | | | | <p>„Komuna ka PVLMJ-një për të gjithë periudhën e hulumtuar (PVLMJ 2012-2018 dhe PVLMJ 2019-2025), por të dyja PVLMJ-të nuk respektojnë kohëzgjatjen e atribuar në nenin 60 të LMJ-së; Në PVLMJ 2012-2018 dhe PVLMJ 2019-2025 janë analizuar shumica e sektorëve nga neni 64 i LMJ, por jo në tërësinë e tyre. Të dy PVLMJ-të përmbajnë masa afatmesme dhe afatgjata për sektorët e analizuar në PVLMJ-të.</p> <p>Komuna ka krijuar organ monitorues nga neni 60 i LMJ-së në gusht 2022 dhe përpiloi një raport për periudhën 2019-2022 që korrespondon me përmbajtjen e masave në PVLMJ 2019-2025.“</p> |

KONKLUZIONE

MMJPH-ja nuk ka miratuar një metodologji për përgatitjen e PVLMJ-së, të parashikuar në nenin 61 paragrafi 3 i LMJ-së.

Në masë të madhe përsëriten të njëjtat situata të përcaktuara në Raportin Teknik për Auditimin e PVLMJ-ve të vitit 2015.

Vetëm 21,88% e komunave në vend kanë të paktën një PVLMJ-në të vlefshme në periudhën 2016-2023, por vetëm 6,25% e komunave kanë pasur PVLMJ-në të vlefshme në të gjithë periudhën 2016-2023.

Të gjitha PVLMJ-të e konsideruara kanë disa mangësi (kohëzgjatja e papërshtatshme, përmbajtja nuk paraqet analiza për të gjitha fushat e LMJ-së, masat për të gjitha fushat e LMJ-së nuk janë përfshirë, masat afatmesme dhe afatgjata nuk janë përfshirë, etj.).

Vetëm 3,125% e komunave kanë përgatitur së paku një raport për zbatimin e PVLMJ-ve.

Organi për monitorimin e zbatimit të PVLMJ-së është krijuar nga 6,25% e komunave.

Megjithëse baza për PVLMJ-në duhet të jetë PVN-ja, vlefshmëria e PVN-së së fundit ka skaduar në vitin 2012 dhe nuk është miratuar asnjë i ri dhe në 2014-2020 ekzistonte Strategjia e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike.⁵ Kjo situatë krijon paqartësi shtesë në sistemin e menaxhimit mjedisit jetësor në nivel qendror dhe lokal.

Është për t'u përsëritur Strategjia për Ndryshime Klimatike që Komuna e Mavrovës dhe Rostushës që e kanë deklaruar në përgjigjen e kërkesës për qasje të lirë në informata me karakter publik, por në të njëjtën kohë shtrohet pyetja nëse miratimi i një dokumenti të tillë ka rëndësi thelbësore për menaxhimin e mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike sepse baza e krijimit të tij nuk është e rregulluar ligjërisht, as qëllimi, përmbajtja, mënyra e monitorimit, raportimi dhe as pasojat e mosmiratimit/moszbatimit të tij.

⁵ Menaxhimi strategjik i mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike në nivel qendror, Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2023

REKOMANDIME

- › Edhe pse komunat në PVLMJ-në deklarojnë se ndjekin tekstet ligjore dhe/ose dokumente⁶ të tjera, është e nevojshme që MMJPH të miratojë metodologjinë nga neni 61 paragrafi 3 i Ligjit për Mjedisin Jetësor për standardizimin dhe uniformitetin në përgatitjen e PVLMJ-së.
- › Nevojitet një analizë më e thellë për arsyet pse ndodhin situatat e përshkruara më sipër (kapacitetet njerëzore, burimet financiare, etj.).
- › Fokusi i komunave duhet të jetë hartimi, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit të dokumenteve që janë ligjërisht të rregulluara dhe të detyrueshme.
- › Ndoshta duhet marrë parasysh ndryshimi i LMJ-së sepse komunat në përgjigjet e tyre thonë se zbatimi i PVLMJ-së kryhet nga administrata komunale dhe jo nga organi i referuar në nenin 60 të LMJ-së.

⁶ Pothuajse të gjitha komunat që kanë të paktën një PVLMJ-në të vlefshme kanë deklaruar se kanë ndjekur Metodologjinë për përgatitjen e PVLMJ-së në kuadër të Udhëzuesit për Komunitet, i cili është përgatitur nga Qendra Rajonale për Mjedisin Jetësor në vitin 2007.

